



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.24 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 36 paragrafi 3 të Ligjit për Gjykatën Komerciale dhe nenit 28 të Ligjit Nr.06/-054 për Gjykatat, në mbledhjen e mbajtur me XX,

Miraton:

RREGULLORE PËR NJËSINË LIGJORE
TË GJYKATËS KOMERCIALE
Nr.XX/2023

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Njesisë Ligjore si njësi organizative në kuadër të Gjykatës Komerciale.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen ndaj të gjithë të punësuarëve në Njësinë Ligjore me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale dhe administrative për Gjykatën Komerciale ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1. **Ligji** - Ligji nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

2. **Këshilli Gjyqësor** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

3. **Gjykata Komerciale** - Gjykata Komerciale ashtu siç parashihet me ligjin për Gjykatën Komerciale.

4. **Kryetari** - Kryetarin e Gjykatës Komerciale, ashtu siç parashihet në Ligjin për Gjykatën Komerciale;

5. **Njësia Ligjore** - Njësia organizative në Gjykatën Komerciale, që i përgjigjet drejtpërdrejtë kryetarit të gjykatës.

6. **Këshilltari Ligjor** - zyrtarë me kompetencë i cili menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të Njesisë Ligjore në mënyrë autonome nën mbikëqyrjen e kryetrait të gjykatës.

7. **Bashkëpunëtori profesional** - zyrtarin me kompetencë profesionale që i ofron mbështetje profesionale gjyqtarit, në kuadër të gjykatës Komerciale.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 4 **Përbërja e Njesisë Ligjore**

1. Njësia Ligjore përbëhet nga:

- 1.1. Këshilltari Ligjor i cili vepron si Kreu i Njesisë;
- 1.2. Bashkëpunëtori Profesional;
- 1.3. Këshilltar profesional,
- 1.4. Zyrtari Ligjor,
- 1.5. Zyrtari i Përkthimeve.

2. Këshilltari Ligjor dhe bashkëpunëtori profesional nuk janë nëpunës civil. Rekrutimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë kuazi-gjyqësore.

3. Përrjashtimisht paragrafit 2 të këtij neni, i gjithë stafi tjetër janë nëpunës civil të Këshillit.

Neni 5 **Funksionet e Njesisë Ligjore**

1. Njësia Ligjore është njësi organizative në Gjykatën Komerciale që i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryetarit të Gjykatës.

2. Njësia Ligjore kryen detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve të

Gjykatës Komerciale, duke kryer hulumtime dhe analiza juridike, duke ndihmuar në hartimin e raporteve, vendimeve dhe materialeve të tjera ligjore në mbështetje të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale.

3. Njësia Ligjore hulumton legjislacionin, autoritetet ligjore dhe jurisprudencën që lidhen me çështjet që i nënshtrohen procedurave në Gjykatën Komerciale, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të gjyqtarit të lëndës të shkallës së parë në një rast të caktuar, ose kryetarin e kolegjit në dhomat e shkallës së dytë.

4. Njësia Ligjore identifikon kërkesat për masa të përkohshme dhe urgjenca të tjera dhe sjell informacionin për kryetarin e gjykatës për veprim të shpejtë.

Neni 6

Ndarja e rasteve në Njësinë Ligjore

1. Pasi lënda të regjistrohet dhe t'i caktohet një gjyqtari, Këshilltari Ligjor emëron një bashkëpunëtor profesional për të ndihmuar gjyqtarin.

2. Këshilltari Ligjor, në konsultim me gjyqtarin përgjegjës për rastin, mund të vlerësojë nëse rasti i caktuar është i një natyre që kërkon angazhimin e një numri më të madh të bashkëpunëtorëve profesional dhe mund të caktojë një ose më shumë bashkëpunëtorë profesional shtesë për një rast të veçantë.

3. Këshilltari Ligjor siguron që ngarkesa me punë të bëhet në mënyrë të ekuilibruar dhe proporcionale për të gjithë bashkëpunëtorët profesional.

4. Për çdo konflikt interesi në lidhje me rastin, bashkëpunëtorët profesionalë e njoftojnë gjyqtarin përgjegjës për lëndën dhe Këshilltarin Ligjor në momentin e parë që është parashikuar ose ka lindur konflikti, ose konflikti i mundshëm.

4.1. Bashkëpunëtori Profesional mund të kërkojë përjashtimin e tij nga një rast specifik për shkak të një konflikti të tillë interesi dhe gjithashtu për arsye të tjera të arsyetuara.

4.2. Nëse gjyqtari përgjegjës për rastin, Këshilltari Ligjor, Kryetari, ose ndonjë punonjës tjetër i Gjykatës vihet në dijeni për një konflikt interesi që nuk është zbuluar nga një bashkëpunëtor profesional, mund të urdhërohet veprimi i duhur përfshirë edhe përjashtimin. Gjyqtari përgjegjës i rastit, në bashkëpunim me kryetarin, vendos për përjashtimin.

5. Në asnjë rast, bashkëpunëtori profesional nuk mund të angazhohen në rastet e njëjta pranë dhomave të shkallës së parë dhe dhomave të shkallës së dytë.

Neni 7

Funksionet e Këshilltarit Ligjor

1. Këshilltari Ligjor udhëheq dhe mbikëqyrë Njësinë Ligjore.

2. Këshilltari Ligjor i raporton drejtpërdrejtë kryetarit të gjykatës.

3. Këshilltari Ligjor kryen funksionet si më poshtë:

- 3.1. ndihmon dhe këshillon gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj;
- 3.2. mbështet anëtarët e Njesisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre;
- 3.3. mbikëqyrë organizimin, veprimtaritë dhe performancën e anëtarëve të Njesisë Ligjore;
- 3.4. merr pjesë në seancat gjyqësore, ndan kërkesat në mënyrë proporcionale, duke marrë parasysh kompleksitetin, nivelin e vështirësisë dhe rëndësinë e referimit, për të gjithë anëtarët e Njesisë Ligjore, në konsultim me kryetarin;
- 3.5. siguron prioritetin e shqyrtimit të çështjes, sipas procedurave dhe udhëzimeve në fuqi të Kryetarit;
- 3.6. i cakton detyra të tjera specifike anëtarëve të Njesisë Ligjore;
- 3.7. përgjithësisht mbikëqyrë anëtarët e Njesisë Ligjore në proceset dhe praktikat thelbësore për përgatitjen e raporteve, hartimin e vendimeve dhe përgatitjen e dokumenteve të tjera ligjore të nevojshme për funksionet e Gjykatës;
 - 3.7.1 siguron cilësi të lartë të zbatimit të standardeve shteruese dhe gjithëpërfshirëse të kërkimit juridik në çështjet përfshirë ligjin kombëtar të Republikës së Kosovës, të drejtën rajonale dhe ndërkombëtare, dhe të drejtën krahasuese, në hartimin e opinioneve dhe rekomandimeve;
 - 3.7.2 siguron që anëtarët e Njesisë Ligjore të ndjekin praktikat më të mira, dhe standardet më të larta profesionale në kryerjen e detyrave në mbështetjen e Gjykatës dhe gjyqtarëve individualë të cilëve i raportojnë;
- 3.8. mbikëqyrë cilësinë dhe i jep gjykatës këshillë në lidhje me konsistencën e vendimmarrjes në gjykatë;
- 3.9. siguron që anëtarët e rinj të Njesisë Ligjore të kenë mbikëqyrje dhe trajnim specifik në përshtatjen e kryerjes së detyrave të tyre;
- 3.10. kryen vlerësimin e performancës së secilit anëtar të Njesisë Ligjore në baza vjetore, ose më shpesh nëse kërkojnë rrethanat;
- 3.11. cakton bashkëpunëtorë profesional, këshilltar profesional dhe zyrtar ligjor që të punojnë me gjyqtarë specifik, në koordinim me kryetarin e gjykatës Komerciale.

Neni 8

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Bashkëpunëtorit Profesional

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëpunëtorit profesional janë të përcaktuara në Katalogun e Pozitave dhe Përshkrimin të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit.
2. Përgjashtimisht nga paragrafit 1 të këtij neni, bashkëpunëtorët profesional në gjykatën Komerciale

kanë të drejtë të plotë, dhe pritet, që t'i japin gjyqtarit përgjegjës për rastin opinionin e tyre profesional në lidhje me rastin, për të cilën nuk do të kenë ndonjë përgjegjësi disiplinore.

Neni 9
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshilltarit Profesional, Zyrtarit Ligjor, Zyrtari i përkthimeve dhe stafit tjetër

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit profesional, zyrtarit ligjor dhe stafit tjetër të Njesisë Ligjore janë të përcaktuara në bazë të ligjeve në fuqi, Katalogut të Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit, dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.

Neni 10
Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet çdo akt tjetër normativ i cili është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: _____. _____. _____